



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

Nr. 5/2021

Hagë, 14/10/2021

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Të premten e javës së shkuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i caktuar në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nxori një urdhër drejtuar Policisë së Kosovës ku i kërkonte të jepte informacion mbi kompetencat dhe mundësitë e tyre për zbatimin e kushteve të caktuara që lidhen me lirin e përkohshëm dhe raste të mëparshme kur kanë zbatuar kushte të tilla.

Urdhri u nxor nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake pas vendimit të lëshuar më 1 tetor nga Paneli i Gjykatës së Apelit lidhur me këtë pikë.

Ditën e martë, të mërkurë dhe të enjte të kësaj jave dha dëshminë e tij dëshmitari i katërt në gjykimin e Salih Mustafës. Pjesa më e madhe e dëshmisë u dha në seancë private pasi për dëshmitarin janë vendosur masa mbrojtëse, ku përfshihet ndryshimi i pamjes dhe i zërit si dhe përdorimi i një pseudonimi.

Dëshmitarit iu bënë pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, Gjykatësit, Mbrojtja e Viktimave dhe Mbrojtësit e Specializuar.

Gjykimi do të vazhdojë të martën, më 2 nëntor, me dëshminë e dëshmitarit të pestë.

Të hënën e javës së ardhshme, pritet të fillojë me dhënien e dëshmisë dëshmitari i parë i Prokurorisë në gjykimin e çështjes gjyqësore së Gucatit dhe Haradinajt.

Ndër lajmet e tjera: javën e kaluar ekipi i Zyrës për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara të Kosovës mbajti një ligjëratë dhe diskutim me studentë nga zona e Gjilanit, të cilëve u dha informacion bazë mbi Gjykatën dhe procedurat e saj si dhe iu përgjigj pyetjeve që drejtuan studentët.

1





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

Nr. 5/2021

Hagë, 14/10/2021

Që prej vitit 2008, Dhoma e Specializuar ka organizuar aktivitete të ngjashme ndërgjegjësuere në gjithë Kosovën me qytetarët e saj, të rinjtë, shoqërinë civile, etj., për t'u dhënë informacion rreth Gjykatës, për të dëgjuar komentet dhe shqetësimet e pjesëmarrësve si dhe për t'u përgjigjur pyetjeve.

Pyetje nga gazetarët

Nuk kishte pyetje.

